

**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"SIMAKU B\_CO" SHPK**  
**EMERTIMI-OBJEKTI-QENDRA-KOHEZGJATJA**

**NENI 1-Emërtimi i shoqërisë**

Shtetasit shqiptare:

**Berti Simaku** i biri i Spiros, lindur në Kavajë më 20/09/1955 me shtetësi dhe kombësi Shqiptare, dhe banues në Kavajë në adresën Lagja Nr. 2 Rr Teferiçve Nd. 57 H 1 Zona 2501 me ID F50920050L ortak i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "SIMAKUB\_CO" sh.p.k.

**Brunilda Gagu** e bija e Bertit, lindur në Kavajë më 08/07/1991 me shtetësi dhe kombësi Shqiptare, dhe banues në Kavajë në adresën Lagja Nr. 2 Rr "Ceno Kavaja" Nd 2190 H 2879 Ap. 093 Zona 2500 me ID J15708107F ortak i shoqërisë me

përgjegjësi të kufizuar e quajtur "SIMAKUB\_CO" sh.p.k.

**Klodjan Simaku** i biri i Bertit, lindur në Kavajë më 06/03/1985 me shtetësi dhe kombësi Shqiptare, dhe banues në Kavajë në adresën Lagja Nr. 2 Rr Teferiçve Nd. 57 H 1 Zona 2501 me ID I50306104V ortak i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "SIMAKUB\_CO" sh.p.k.

**Adam Simaku** i biri i Bertit, lindur në Kavajë më 20/08/1988 me shtetësi dhe kombësi Shqiptare, dhe banues në Tiranë në adresën Rr Frosina Plaku Kompleksi Kontakt Pallati ANTLIA Kati5/155 Njësia Bashkiake nr 7 me ID I80820111A ortak i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "SIMAKUB\_CO" sh.p.k.

Shoqëria është person juridik dhe do ushtrojë veprimtarinë në bazë të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 «Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare» i ndryshuar.

**NENI 2—Objekti i veprimtarisë së shoqërisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do jete si vijon:

Importi, Eksporti, Prodhimi dhe tregtimi i artikujve të drurit. Tregtimi i Artikujve te tjerë industriale.

**NENI 3-Kohëzgjatja e veprimtarisë**

Shoqëria do te ushtrojë aktivitetin tregtar do jetë subjekt i të drejtës shqiptare pa afat të përcaktuar.

Me vendim të ortakëve afati i mësipërm mund te ndryshojë ose shoqëria mund të shkrihet.



#### NENI 4-Vula

Shoqëria do të ketë vulën e vet në formën e përcaktuar nga ortakët

#### NENI 5 -Selia e shoqërisë

Shoqëria "SIMAKU B\_CO" Sh.p.k ka qendrën në Kavajë në adresën Kavajë Synej RRAKULL Rrakull, Zona Kadastrale nr.3204, Numër Pasurie 68/99, Volumi 7, Faqe 72. dhe do të ketë të drejtë të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria mund të krijojë agjenci, zyra përfaqësimi, qendra dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### NENI 6- Kapitali i regjistruar

Kapitali i shoqërisë është LEKE 100.000 (njëqind mijë lekë) dhe është kapital i ndarë në 4 kuota sipas ortakëve respektivisht:

**Berti Simaku** i biri i Spiros, lindur në Kavajë më 20/09/1955 me shtetësi dhe kombësi Shqiptare, dhe banues në Kavajë në adresën Lagja Nr. 2 Rr Teferiçve Nd. 57 H 1 Zona 2501 me ID F50920050L. Pjesa në pronësi: 15% (pesëmbëdhjetë-përqind) të aksioneve, ose 1 kuotë në vlerën 15.000 Lekë (pesëmbëdhjetë mijë leke).

**Brunilda Gagu** e bija e Bertit, lindur në Kavajë më 08/07/1991 me shtetësi dhe kombësi Shqiptare, dhe banues në Kavajë në adresën Lagja Nr. 2 Rr "Ceno Kavaja" Nd 2190 H 2879 Ap. 093 Zona 2500 me ID J15708107F. Pjesa në pronësi: 20% (pesëmbëdhjetë-përqind) të aksioneve, ose 1 kuotë në vlerën 20.000 Lekë (njëzetë mijë leke).

**Klodjan Simaku** i biri i Bertit, lindur në Kavajë më 06/03/1985 me shtetësi dhe kombësi Shqiptare, dhe banues në Kavajë në adresën Lagja Nr. 2 Rr Teferiçve Nd. 57 H 1 Zona 2501 me ID I50306104V. Pjesa në pronësi: 35% (tridhjetë e pesë-përqind) të aksioneve, ose 1 kuotë në vlerën 35.000 Lekë (tridhjetë e pesë mijë leke).

**Adam Simaku** i biri i Bertit, lindur në Kavajë më 20/08/1988 me shtetësi dhe kombësi Shqiptare, dhe banues në Kavajë në adresën Rr Frosina Plaku Kompleksi Kontakt Pallati ANTLIA Kati5/155 Njësia Bashkiake nr 7 me ID I80820111A Pjesa në pronësi: 30% (tridhjetë përqind) të aksioneve, ose 1 kuotë në vlerën 30.000 Lekë (tridhjetë mijë leke).

Kapitali i shoqërisë mund të rritet apo zvogëlohet me vendim të ortakëve.

#### NENI 7-Transferimi i kuotave

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme.

1.Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre me vendim të

ortakëve mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- c) dhurimit; (si personave që kanë lidhje gjaku me ortakët ashtu edhe të tjerëve pa lidhje gjaku)
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontrate, kontrata duhet të behet me shkrim.

## NENI 8—Ortakët

Shoqëria zotërohet nga katër ortakë dhe të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga të katërt ortakët. Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- Investimet e reja;
- Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria vendos ndryshe.

## NENI 9 –Drejtimi dhe administrimi

9.1 Shoqëria tregtare "SIMAKU B\_CO" sh.p.k do drejtohet nga një administrator që emërohet me vendim të ortakëve.

Administrator i Shoqërisë duke filluar nga data e sotme për pesë vitet në vazhdim (20/07/2022 deri 19/07/2027) do të jetë Ortaku Klodjan Simaku

9.2 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortakët;
- përfaqëson shoqërinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e

- fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakëve për miratim;
- krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - raporton përpara ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

9.3 Ortakët mund ta shkarkojnë administratorin në çdo kohë. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund ta përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

9.4. Administratori do shpërblehet sipas përcaktimit të ortakëve në përputhje me parashikimin e nenit 97 të ligjit nr.9901 date 14.04.2008.

9.5 Administratori ka të drejtë të caktojë dhe revokojë persona të tretë në mungesë dhe për llogari të tij.

### NENI 10-Kontrolli i brendshëm

Shoqëria tregtare organizon kontrollin e brendshëm me një kontabël të miratuar, i cili është përgjegjës përpara kësaj shoqërie për dëmet që mund të shkaktojë nga moskryerja në rregull e detyrës së tij.

### NENI 11—Bilanci dhe të ardhurat

Veprimet ekonomike e financiare të shoqërisë mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti përveç rasteve e urdhrave të veçanta të ortakëve të saj. Në fund të çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabël me rezultatin ekonomik HUMBJE FITIME.

Bilanci kontabël miratohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe pas përcaktimit të detyrimeve fiskale pjesa që mbetet i jepet për përdorim ortakëve të saj.


### NENI 12—Shpërbërja e shoqërisë

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak. Në rast shkrirje të shoqërisë, Ortakët vendosin mbi mënyrat e likuidimit dhe caktojnë një ose më shume likuidatorë duke iu përcaktuar edhe detyrat.

Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënimi:

**SHOQERI NE LIKUIDIM E SIPER.**

Administratori regjistron prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".




NENI 13- Dispozita përfundimtare

Për sa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut do i referohet plotësisht të bëra nga ORTAKET.

Shoqëria "SIMAKU B\_CO" Sh.p.k do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare dhe do ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar në përgjithësi dhe normat e këtij statuti.

Ky statut nënshkruhet prej ortakëve në datë 20/07/2022.

ORTAKET

Beski Simaku  Brunilda Gogu 

KLONJAN SIMAKU 

Adem Simaku 